



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 231, Datë 19.07.2023

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/11 prot., datë 18.07.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 19.06.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.06.2023 dhe 21.06.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.06.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1271/8 prot., datë 23.06.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 195/2023 dhe dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Në datën 17.07.2023, shoqëria depozitoi në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria në kuadër të plotësimit të dosjes së aplikimit dhe nevojës që mund të lindë për korrespondencë të mëtejshme pas shqyrtimit të tij, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI